

BANKA E SHQIPËRISË

B U L E T I N I  
Z Y R T A R

---

vëllimi 24    numër 3    maj 2022

Data e botimit: 1.6.2022



P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë nr.1839, datë 28.4.2022 “Për dhënien e miratimit paraprak për ushtrimin e veprimtarisë financiare shtesë nga subjekti financiar jobankë “FAB INVEST” sh.p.k.” 4
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.25, datë 4.5.2022 “Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë” 5
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.26, datë 4.5.2022 “Për miratimin e rregullores “Për strukturën dhe përdorimin e numrit ndërkombëtar të llogarisë së pagesës”” 6
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.28, datë 4.5.2022 “Për disa ndryshime në fondin numizmatik të Bankës së Shqipërisë” 22
5. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë nr.2202, datë 23.5.2022 “Për dhënien e miratimit paraprak për ushtrimin e veprimtarisë si agjent në sigurime nga institucioni i parasë elektronike “RPAY” sh.p.k.” 24
6. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 24, numër 1, shkurt 2022 26
7. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 24, numër 2, prill 2022 26



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**GUVERNATORI**

**VENDIM**  
Nr. 1839, datë 28.4.2022

**PËR**  
**DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË**  
**FINANCIARE SHITESË NGA SUBJEKTI FINANCIAR JOBANKË**  
**"FAB INVEST" SH.P.K.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 16, pika 1, shkronja "a", nenit 18, nenit 19 dhe nenit 20 të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka", miratuar me vendimin nr. 1, datë 17.1.2013 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar; dhe të shtojcës nr. 3, pika 5 të rregullores "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare", miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.5.2010 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar; pasi u njoha me kërkesën e subjektit financiar jobankë "FAB INVEST" sh.p.k., dhe bazuar në propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSA:

1. Miratimin paraprak për subjektin financiar jobankë "FAB INVEST" sh.p.k. për ushtrimin e veprimtarisë financiare shtesë për të gjitha format e kredidhënies.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**GUVERNATOR**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 25, datë 4.5.2022

**PËR**  
**MBAJTJEN E PANDRYSHUAR TË NORMËS SË INTERESIT TË**  
**MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLA TË RIBLERJES DHE**  
**TË NORMAVE TË INTERESIT TË DEPOZITËS NJËDITORE DHE TË KREDISË**  
**NJËDITORE NË BANKËN E SHQIPËRISË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat "a" dhe "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 1.00 për qind, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella).
2. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 0.10 për qind, normën e interesit që Banka e Shqipërisë i paguan një banke tregtare për depozitën njëditore.
3. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 1.9 për qind, normën e interesit që një bankë tregtare i paguan Bankës së Shqipërisë për kredinë njëditore.
4. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare të njoftojë menjëherë bankat tregtare për këtë vendim.
5. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare dhe të gjitha strukturat e tjera në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në faqen zyrtare të internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**KRYETARI**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 26, datë 4.5.2022

**PËR**  
**MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR STRUKTURËN DHE PËRDORIMIN E**  
**NUMRIT NDËRKOMBËTAR TË LLOGARISË SË PAGESËS"**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja "b", nenit 3, pika 2 dhe pika 4, shkronja "dh", nenit 12, shkronja "a", nenit 21 dhe nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 129, pika 6 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 15, pika 1 të ligjit nr.133, datë 29.4.2013 "Për sistemin e pagesave"; si dhe nenit 81 të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020 "Për shërbimet e pagesave"; me propozimin e Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë rregulloren "Për strukturën dhe përdorimin e numrit ndërkombëtar të llogarisë së pagesës", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetet dhe Financës, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, Departamenti i Mbikëqyrjes, Departamenti i Operacioneve Monetare në Bankën e Shqipërisë, si dhe të gjitha subjektet e përcaktuara si ofrues të shërbimeve të pagesave sipas nenit 3 pika 2 të ligjit "Për shërbimet e pagesave" (kur është e zbatueshme me klientët për të cilët çelin llogari), me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 42, datë 16.7.2008 "Për strukturën dhe përdorimin e numrit ndërkombëtar të llogarisë bankare (IBAN)".
4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**SEKRETARI**

**KRYETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**GENT SEJKO**

## KREU I TË PËRGJITHSHME

### Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i strukturës së numrit ndërkombëtar të llogarisë së pagesës, i marrëdhënieve ndërmjet ofruesve të shërbimeve të pagesave të përcaktuar në nenin 3, pika 2 të ligjit "Për shërbimet e pagesave", kur është e zbatueshme, me klientët e tyre në lidhje me krijimin, komunikimin, njohjen dhe përdorimin e numrit ndërkombëtar të llogarisë së pagesës në Republikën e Shqipërisë, si dhe i procedurave për kontrollin e vlefshmërisë së tij prej ofruesve të shërbimeve të pagesave.

### Neni 2 Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

- a) ligjit "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- b) ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- c) ligjit "Për sistemin e pagesave";
- d) ligjit "Për shërbimet e pagesave";
- e) akteve të tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë në fushën e sistemit dhe shërbimeve të pagesave.

### Neni 3 Fusha e zbatimit

1. Subjekte të kësaj rregulloreje janë ofruesit e shërbimeve të pagesave të përcaktuar në nenin 3, pika 2 të ligjit "Për shërbimet e pagesave", kur është e zbatueshme.
2. Banka e Shqipërisë zbaton dispozitat e kësaj rregulloreje në lidhje me numrin ndërkombëtar të llogarisë së pagesës në rolin e operatorit, si dhe për kryerjen e pagesave për klientët e saj.

### Neni 4 Përkufizime

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore, të gjitha përkufizimet e parashikuara në ligjin "Për shërbimet e pagesave" dhe në ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" vlejnë edhe për këtë rregullore.
2. Për qëllim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:
  - a) **IBAN** – është një identifikues ndërkombëtar i numrit të llogarisë së pagesës, elementet e të cilit përcaktohen nga Organizata



- Ndërkombëtare për Standardizim (ISO), i cili identifikon qartë një llogari individuale të pagesës;
- b) **BBAN** – është një identifikues kombëtar i numrit të llogarisë së pagesës, i cili identifikon qartë një llogari individuale të pagesës me një OSHP dhe që mund të përdoret vetëm për transaksionet e pagesave kombëtare, në rastet kur nuk kërkohet IBAN nga kuadri rregullator në fuqi, ndërsa e njëjta llogari pagese identifikohet në mënyrë të pakushtëzuar nga IBAN për transaksionet e pagesave ndërkufitare;
  - c) **BIC** – është një kod identifikues biznesi, elementet e të cilit përcaktohen nga ISO, i cili identifikon qartë në nivel ndërkombëtar një OSHP. Ky kod përcaktohet nga SWIFT;
  - d) **KIB** – është një kod identifikues biznesi që identifikon qartë në nivel kombëtar një OSHP të licencuar për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Ky kod përcaktohet nga Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me OSHP, sipas kësaj rregulloreje;
  - e) **Karakteret numerike** – janë karakteret që bëjnë pjesë në bashkësinë e numrave nga 0 deri në 9;
  - f) **Karakteret alfabetike** – janë karakteret që bëjnë pjesë në bashkësinë e shkronjave të mëdha të alfabetit anglez nga A në Z;
  - g) **Karakteret alfanumerike** – janë të gjitha karakteret numerike dhe alfabetike;
  - h) **Klient** – është zotëruesi i një llogarie (titullar i llogarisë) në monedhë vendase apo të huaj, pranë një OSHP;
  - i) **Urdhër pagese** – është një instruksion nga një pagues ose përfitues pagese për OSHP e tij, që kërkon kryerjen e një transaksioni pagese;
  - j) **Transaksion pagese** – është një veprim i iniciuar nga paguesi ose përfituesi për transferim fondesh midis llogarish pagese, pavarësisht nga detyrimet ndërmjet paguesit dhe përfituesit;
  - k) **ISO** – (International Organization for Standardization) është Organizata Ndërkombëtare për Standardizim;
  - l) **SWIFT** – (Society for Worldwide Interbank Financial Telecommunication) – është shoqëri ndërkombëtare, që ofron platformë për shkëmbimin e informacioneve financiare në mënyrë të sigurt dhe të besueshme, duke mundësuar automatizimin dhe standardizimin e transaksioneve financiare;
  - m) **Njësi të rrejtit të OSHP** – janë degët dhe/ose agjencitë dhe agjentët e një OSHP në territorin e Republikës së Shqipërisë;
  - n) **OSHP** – është ofrues i shërbimeve të pagesave i përkufizuar si një nga subjektet e përcaktuara në pikën 2, të nenit 3 të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, ose një person fizik tregtar ose juridik që ofron shërbime pagesash e që përfiton nga përjashtimet sipas neneve 27 ose 28 të këtij ligji;
  - o) **Llogari pagese** – është një llogari në emër të një ose më shumë përdoruesish të shërbimeve të pagesave, e cila përdoret për kryerjen e transaksioneve të pagesave;
  - p) **Kod unik i identifikimit** – është një kombinim shkronjash, numrash

- apo simbolesh të përcaktuara për përdoruesin e shërbimit të pagesave nga ofruesi i shërbimeve të pagesave e që përdoret nga përdoruesi i shërbimit të pagesave për t'u dalluar qartë nga një përdorues tjetër i shërbimit të pagesave dhe/ose nga llogaria e pagesës së atij përdoruesi tjetër të shërbimit të pagesës, për një transaksion pagese. Për qëllime të kësaj rregulloreje, "kodi unik i identifikimit" nënkupton IBAN ose BBAN aty ku nuk kërkohet ndryshe nga kuadri rregullator në fuqi;
- q) **Mjet i qëndrueshëm komunikimi** – është çdo mjet komunikimi që i mundëson përdoruesit të shërbimeve të pagesave ruajtjen e informacionit adresuar personalisht atij përdoruesi të shërbimeve të pagesave, në një mënyrë të tillë që mundëson përdorimin e këtij informacioni si referencë në të ardhmen, për një periudhë kohe të përshtatshme për qëllimet e informacionit e që lejon riprodhimin e pandryshuar të informacionit të ruajtur;
- r) **Transfertë krediti** – është një shërbim pagese për kreditimin e llogarisë së pagesës së një përfituesi me një transaksion pagese ose një seri transaksionesh pagese nga llogaria e pagesës së paguesit që kryhet nga ofruesi i shërbimit të pagesës, i cili mban llogarinë e pagesës së paguesit, bazuar në udhëzimin e dhënë nga paguesi;
- s) **Debitim direkt** – është një shërbim pagese për debitimin e llogarisë së pagesës së paguesit, ku një transaksion pagese iniciohet nga përfituesi i pagesës, në bazë të pëlqimit që paguesi i ka dhënë përfituesit të pagesës, ofruesit të shërbimit të pagesave të përfituesit të pagesës ose ofruesit të shërbimit të pagesave të vet paguesit.
3. Në këtë rregullore, fjalët në njëjës mund të interpretohen në shumës dhe anasjelltas, kurdoherë që një gjë e tillë është e nevojshme nga përmbajtja e dispozitës ose konteksti.
4. Termat në gjininë mashkullore nënkuptojnë dhe gjininë femërore, dhe anasjelltas.
5. Anekset bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë pjesë përbërëse e saj.

## Neni 5

### Qëllimi i përdorimit të IBAN si kod unik i identifikimit të llogarisë së pagesës

Përdorimi i IBAN, si nga OSHP iniciues të pagesave ashtu edhe nga OSHP përfitues të pagesave, bëhet me qëllim:

- a) identifikimin në mënyrë të vetme të llogarisë së pagesës, duke përdorur një format të standardizuar të paraqitjes së saj;
- b) përpunimin automatik të identifikimit të llogarive të pagesës; dhe
- c) unifikimin dhe standardizimin e procesit të kontrollit të vlefshmërisë së llogarive të pagesës.

## KREU II STRUKTURA E KODEVE TË IDENTIFIKIMIT

### Neni 6 Struktura e IBAN

1. IBAN në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga 28 karaktere alfanumerike që përfaqësojnë elementet e mëposhtme sipas vendosjes në IBAN:
  - a) në pozicionet 1 dhe 2 – kodin e Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga 2 karakteret "AL", në përputhje me standardin ndërkombëtar ISO 3166 "Kodet për përcaktimin e emrave të shteteve dhe nënndarjeve të tyre";
  - b) në pozicionet 3 dhe 4 – shifrën e kontrollit të IBAN, 2 karaktere numerike që i korrespondojnë vlerës së kontrollit të llogaritur sipas algoritmit MOD 97-10, siç është shpjeguar në Aneksin 2 (referuar standardit ndërkombëtar ISO 7064 "Teknologjia e informacionit – teknikat e sigurisë – sistemet e karaktereve të kontrollit");
  - c) në pozicionet 5 deri 28 – BBAN në Republikën e Shqipërisë.

### Neni 7 Struktura e BBAN

BBAN në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga 24 karaktere alfanumerike që përfaqësojnë elementet e mëposhtme sipas vendosjes në IBAN:

- a) në pozicionet 5 deri 12 – KIB të përbërë nga 8 karaktere numerike, që përcaktojnë në mënyrë unike OSHP dhe njësinë e rrjetit të tij në të cilën është hapur llogaria e klientit;
- b) në pozicionet 13 deri 28 – llogarinë e pagesës së klientit të përbërë nga 16 karaktere alfanumerike. Llogaria e klientit përcaktohet nga vetë OSHP dhe mund të përmbajë në formatin e saj edhe shifër kontrolli, në përputhje me strukturën që çdo OSHP zbaton. Në rast se identifikuesi i llogarisë së pagesës me OSHP përbëhet nga më pak se 16 karaktere, pjesa tjetër e karaktereve plotësohet me karaktere numerike "0" përpara.

### Neni 8 Struktura e KIB

1. KIB është një kod identifikues kombëtar për OSHP dhe/ose njësinë e rrjetit të OSHP që kryen transaksione pagesash, është pjesë përbërëse e IBAN dhe BBAN, si dhe përbëhet nga 8 karaktere numerike, që përfaqësojnë elementet e mëposhtme sipas vendosjes në KIB:
  - a) në pozicionet 1 deri 3 – kodin unik të OSHP, i cili përcaktohet nga Banka e Shqipërisë, sipas tabelës 1 të Aneksit 5 duke pasur parasysh se:

- karakteri në pozicionin 1 tregon klasifikimin e OSHP,
- karakteret në pozicionet 2 dhe 3 shërbejnë për identifikimin e OSHP nëpërmjet një numri unik dyshifror;
- b) në pozicionet 4 deri 7 – kodin unik të njësisë së rrejtë të OSHP (degë/agjenci/agjent), i cili përcaktohet nga vetë OSHP, sipas tabelës 1 dhe tabelës 2 të Aneksit 5 duke pasur parasysh se:
  - karakteret në pozicionet 4 dhe 5 shërbejnë për të identifikuar rrethin ku ndodhet njësia e OSHP,
  - karakteret në pozicionet 6 dhe 7 shërbejnë për identifikimin e njësive të OSHP nëpërmjet një numri dyshifror dhe përcaktohen nga vetë OSHP, në përputhje me politikën e saj të brendshme;
- c) në pozicionin 8 – shifrën e kontrollit të KIB, që përcaktohet sipas metodës së paraqitur në Aneksin 4.

### **KREU III PROCEDURAT DHE DETYRIMET E LIDHURA ME IBAN**

#### **Neni 9 Paraqitja e IBAN**

IBAN paraqitet:

- a) në instruksionet elektronike të pagesave: pa hapësira boshe ose simbole ndarëse midis karaktereve; dhe/ose
- b) në dokumentet e pagesave në format letër: në sekuenca karakteresh të grupuara me nga katër karaktere të ndara me nga një hapësirë boshe.

#### **Neni 10 Krijimi i IBAN**

1. Krijimi i IBAN është procesi i përcaktimit të karaktereve në përbërje të IBAN për çdo llogari pagese klienti.
2. OSHP krijon IBAN në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje.
3. OSHP duhet të krijojë një IBAN për çdo llogari pagese njëkohësisht me hapjen e saj.
4. OSHP mban përgjegjësi përkundrejt klientit zotërues të llogarisë së pagesës, sipas legjislacionit të zbatueshëm, për saktësinë e IBAN të krijuar.

#### **Neni 11 Komunikimi i IBAN**

1. Komunikimi i IBAN është procesi i njoftimit të klientit titullar të llogarisë së pagesës në lidhje me krijimin e IBAN për llogarinë e tij të pagesës.
2. OSHP duhet t'i komunikojë çdo klienti mbajtës të një llogarie pagese pranë saj, IBAN-in e llogarisë së tij.

3. IBAN dhe kodi BIC i OSHP, sipas rastit, i komunikohen klientit të OSHP në formë të dokumentuar, si më poshtë:
  - a) nëpërmjet përcaktimit të tyre në dokumentet e hapjes së një llogarie pagese të re, që i vihen në dispozicion klientit;
  - b) nëpërmjet komunikimit me shkrim në përgjigje të kërkesës së klientit;
  - c) nëpërmjet vendosjes së tyre në dokumentin e nxjerrjes së llogarisë; ose
  - d) nëpërmjet shfaqjes së tyre në platformat homebanking ose nëpërmjet mjeteve të qëndrueshme të komunikimit elektronik në distancë, si dhe përmes konfirmimeve përkatëse, gjatë kohës që klienti kryen veprime me llogarinë e pagesës dhe/ose nëpërmjet vendosjes së tyre në dokumente të tjera që lidhen me llogarinë e pagesës.

### **Neni 12** **Përdorimi i IBAN**

1. Përdorimi i IBAN është i detyrueshëm për identifikimin e llogarive të pagesës në transfertat e kreditit, debitimit direkt dhe shërbime të tjera pagesash, të cilat procesohen në sistemet kombëtare të klerimit dhe shlyerjes së pagesave.
2. Numrat e llogarive të pagesës të klientëve, që përdoren për të kryer pagesa në monedhën vendase ose në valutë të huaj, nëpërmjet sistemeve të pagesave apo bankave korrespondente, duhet të kenë formatin IBAN, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
3. OSHP për kryerjen e pagesës, kërkon nga klienti, i cili urdhëron pagesën, IBAN-in e përfituesit, në rastet kur është i aplikueshëm, si dhe kodin BIC të OSHP të përfituesit.
4. OSHP mund të refuzojë të kryejë pagesën, kur klienti nuk paraqet IBAN të llogarisë së pagesës së përfituesit të pagesës dhe/ose kodin BIC të OSHP të përfituesit.
5. OSHP mund të zbatojë komisione shtesë për kryerjen e transfertës, në rastet kur klienti nuk paraqet kodin IBAN të përfituesit dhe/ose kodin BIC të OSHP të përfituesit. Në raste të tilla, përpara kryerjes së transfertës, OSHP pajis klientin me një informacion me shkrim mbi komisionet shtesë të zbatueshme.
6. Në rastin e pagesave ndërkufitare, OSHP-të zbatojnë dispozitat e pikave 3, 4 dhe 5 të këtij neni, për aq kohë sa IBAN zbatohet në vendin e përfituesit.

### **Neni 13** **Kontrolli i vlefshmërisë së IBAN**

1. Kontrolli i vlefshmërisë së IBAN është procesi i përlllogaritjes së vlerës së kontrollit dhe verifikimi nëse paraqitet saktësisht në karakteret që përfaqësojnë shifrën e kontrollit në IBAN.
2. Nëse vlera e përlllogaritur e kontrollit përputhet me paraqitjen në karakteret korresponduese të shifrës së kontrollit në IBAN, atëherë ai IBAN quhet i vlefshëm.
3. Kontrolli i vlefshmërisë së IBAN realizohet sipas "Metodës së

kontrollit të vlefshmërisë së shifrës së kontrollit të IBAN" të paraqitur në Aneksin 3.

#### Neni 14

##### Trajtimi i rasteve pas kontrollit të vlefshmërisë së IBAN

1. OSHP, e cila përpunon dhe ekzekuton instruksionin e pagesës, kontrollon paraprakisht vlefshmërinë e IBAN, në rastet kur është i aplikueshëm, të llogarive të pagesës të dërguesit/ve dhe marrësit/ve, në hyrje dhe në dalje, pavarësisht paraqitjes së IBAN në format elektronik apo letër. Në rast se nga procedurat e kontrollit të vlefshmërisë së IBAN rezulton se IBAN është i pavlefshëm, OSHP refuzon të kryejë pagesën në fjalë.
2. Sistemet kombëtare për klerimin dhe shlyerjen e pagesave kontrollojnë vlefshmërinë e IBAN, për instruksionet e pagesave që kryhen përmes këtyre sistemeve dhe në rast se IBAN rezulton i pavlefshëm refuzojnë klerimin dhe shlyerjen e pagesës në fjalë.
3. Kryerja e kontrollit të vlefshmërisë së IBAN sipas përcaktimeve në këtë rregullore, është parakusht për të vijuar ekzekutimin e urdhërpagesës.

#### Neni 15

##### Trajtimi i rasteve me IBAN të pasaktë

1. Në zbatim të nenit 81 të ligjit "Për shërbimet e pagesave", në rastin kur urdhërpagesa është ekzekutuar në përputhje me kodin unik të identifikimit (IBAN), urdhërpagesa konsiderohet se është ekzekutuar saktësisht për përfituesin e pagesës të përcaktuar nga kodi unik i identifikimit (IBAN), pas kontrolleve të përcaktuara në nenet 13 dhe 14 të kësaj rregulloreje.
2. Në rastin kur kodi unik i identifikimit (IBAN) i dhënë nga përdoruesi i shërbimeve të pagesave është i pasaktë, OSHP nuk është përgjegjës, sipas nenit 82 të ligjit "Për shërbimet e pagesave", për mosekzekutimin ose ekzekutimin e gabuar të transaksionit të pagesës.
3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, OSHP i paguesit bën përpjekje të arsyeshme për të rikuperuar fondet e përfshira në transaksionin e pagesës. OSHP i përfituesit të pagesës gjithashtu bashkëpunon në këto përpjekje, duke i komunikuar OSHP të paguesit të gjithë informacionin në dispozicion për mbledhjen e fondeve.
4. Në rast se mbledhja e fondeve, sipas pikës 3 të këtij neni, nuk është e mundur, OSHP i paguesit i siguron paguesit, pas një kërkesë me shkrim, të gjithë informacionin në dispozicion të OSHP të paguesit dhe që paraqet interes për paguesin, me qëllim paraqitjen e një ankese ligjore për të rikuperuar fondet.
5. Nëse është rënë dakord në kontratën tip, OSHP mund të tarifojë përdoruesin e shërbimeve të pagesave për rimbursimin e fondeve.
6. OSHP është përgjegjës vetëm për ekzekutimin e transaksioneve të pagesës, sipas kodit unik të identifikimit (IBAN) të dhënë nga

përdoruesi i shërbimeve të pagesave, pavarësisht nëse përdoruesi i shërbimeve të pagesave jep informacion shtesë veç atij që specifikohet në nenin 38, pika 1, shkronja "a" ose në nenin 45, shkronja "b", nënndarja "ii" të ligjit "Për shërbimet e pagesave".

#### **KREU IV DETYRIMET E LIDHURA ME KIB**

##### **Neni 16 Detyrimet e Bankës së Shqipërisë në lidhje me KIB**

1. Detyrimet e Bankës së Shqipërisë në lidhje me KIB janë si më poshtë:
  - a) pajis OSHP e licencuar me tre karakteret e para të KIB sipas përcaktimit në këtë rregullore;
  - b) konfirmon saktësinë e pjesës së KIB të përcaktuar nga vetë OSHP, për njësitë e rrjetit të saj sipas nenit 8 të kësaj rregulloreje;
  - c) informon pjesëmarrësit në sistemet e pagesave, për KIB të rinj, si dhe për mbyllje të KIB;
  - d) mban, përditëson dhe publikon regjistrin e kodeve KIB;
  - e) informon kompaninë SWIFT, për ndryshimet në regjistrin e kodeve KIB.
2. Departamenti në Bankën e Shqipërisë që mbulon fushën e sistemeve të pagesave, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit për licencimin e OSHP, për të zhvilluar veprimtari bankare dhe/ose financiare në Republikën e Shqipërisë, përcakton dhe i komunikon OSHP pjesën e parë të KIB (karakteret 123) bazuar në shërbimet e pagesave të cilat OSHP do të ofrojë dhe përcaktimet në tabelën 1 të Aneksit 5.

##### **Neni 17 Detyrimi i OSHP në lidhje me KIB**

1. Për çështje të lidhura me KIB, OSHP komunikon në çdo rast me Departamentin në Bankën e Shqipërisë që mbulon fushën e sistemeve të pagesave.
2. OSHP njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë në lidhje me çdo ndryshim në listën e KIB të OSHP, për të cilin mund të nevojitet kryerja e përditësimeve përkatëse në Regjistrin e Kodeve KIB.
3. OSHP njofton menjëherë Bankën e Shqipërisë në lidhje me krijimin e KIB për çdo njësi të re të rrjetit të OSHP të hapur, si dhe komunikon adresën e saktë të vendndodhjes së çdo njësie të rrjetit të tij.
4. OSHP njofton Bankën e Shqipërisë në rastet kur:
  - a) ka ndryshime për shkak të politikave të OSHP si bashkime, mbyllje, falimentime etj.;
  - b) ka ndryshime të vendndodhjes së degëve/agjencive/agjentëve të saj për sa i përket rajonit;

- c) mbyllet një/ose disa prej njësisve të rrjetit të tij (degë/agjenci/agjentë).
5. OSHP komunikon KIB në çdo dokument të nxjerrë prej tij, me përjashtim të dokumenteve ku jepen IBAN dhe BIC.
6. OSHP nuk mund të ndryshojë karakteret e një KIB ekzistues, por vetëm mund ta mbyllë atë.
7. Në rastin e mbylljes së një KIB ekzistues, OSHP duhet të kujdeset për administrimin e duhur të IBAN-eve të lëshuar me KIB që do të mbyllet.

## **KREU V TË FUNDIT**

### **Neni 18 Sanksionet**

Banka e Shqipërisë, në rast të verifikimit të mosrespektimit dhe/ose të shkeljeve të dispozitave të kësaj rregulloreje nga ana e një OSHP, ka të drejtë të vendosë një ose disa nga masat e përcaktuara në ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjin "Për shërbimet e pagesave".

**KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS**

**GENT SEJKO**



## ANEKS 1 STRUKTURA E IBAN

IBAN					
		BBAN			
		KIB			llogaria e pagesës së klientit pranë OSHP
AL	NN	NNN	NNNN	N	SSSSSSSSSSSSSSSS
kodi i shtetit	2 karaktere kontrolli	kodi identifikues i OSHP	kodi identifikues i degës	1 karakter kontrolli	16 karaktere të vendosura nga vetë OSHP.
përcaktuar "AL" për Republikën e Shqipërisë	përcaktuar sipas MOD 97-10	3 karaktere përcaktuar nga Banka e Shqipërisë	2 karaktere vendndodhja sipas tabelës 2 / aneksi 5 2 karaktere përcaktuar nga OSHP	përcaktuar sipas formulës në aneksin 4	në mënyrë unike përcaktojnë llogarinë e klientit pranë OSHP

N – nënkupton karakter numerik nga 0 deri në 9.

S – nënkupton karakter alfanumerik nga 0 në 9 dhe/ose nga A në Z (vetëm shkronja të mëdha të alfabetit anglez).

### Shembull i IBAN

Numri i llogarisë së klientit	235698741
BBAN	212110090000000235698741
IBAN-i format elektronik	AL47212110090000000235698741
IBAN-i format letër	AL47 2121 1009 0000 0002 3569 8741

## ANEKS 2 METODA E PËRLOGARITJES SË SHIFRËS SË KONTROLLIT (CHECK DIGITS) TË IBAN

### Hapi paraprak

Për të shpjeguar përlogaritjet, marrim një kod IBAN shembull, i cili përfshin kodin e Shqipërisë "AL", karakteret e kontrollit "XX", të cilat po i vendosim paraprakisht me "00", si dhe numrin e llogarisë BBAN prej 24 karakteresh (pa hapësira).

Si algoritëm për llogaritjen e karaktereve të kontrollit "XX" përdoret procedura ISO 7064, MOD 97-10, ilustruar si më poshtë:

Shembull: AL00212110090000000235698741

### Hapi 1

Katër karakteret e para i zhvendosim në fund (në të djathtë) të kodit IBAN:

Bëhet 212110090000000235698741AL00

### Hapi 2

Konvertohen të gjitha shkronjat në numra sipas tabelës më poshtë:

A = 10	G = 16	M = 22	S = 28	Y = 34
B = 11	H = 17	N = 23	T = 29	Z = 35
C = 12	I = 18	O = 24	U = 30	
D = 13	J = 19	P = 25	V = 31	
E = 14	K = 20	Q = 26	W = 32	
F = 15	L = 21	R = 27	X = 33	

Bëhet 212110090000000235698741102100

### Hapi 3

Zbatohet MOD 97-10 (Ref ISO 7064).

Përlogaritjet moduli 97, që do të thotë gjendet mbetja e pjesëtimit me 97 të vlerës së rezultuar nga Hapi 2. Numri i përfutur zbritet nga 98. Nëse diferenca jep një numër njëshifror, atëherë shtohet një zero përpara numrit për të përfutur dy karaktere numerike që do të vendosen në pozicionet pas karaktereve "AL".

Nga përlogaritja rezulton:  $98 - 51 = 47$

IBAN është AL47212110090000000235698741

### ANEKS 3 METODA E KONTROLLIT TË VLEFSHMËRISË SË SHIFRËS SË KONTROLLIT (CHECK DIGITS) TË IBAN

#### Hapi paraprak

Në rast se IBAN paraqitet në format letër, së pari bëhet konvertimi në format elektronik duke hequr të gjitha hapësirat boshe midis karaktereve. Shembulli do të na ndihmojë të bëjmë një paraqitje të metodës së vlerësimit të vlefshmërisë së IBAN.

Shembull: AL47 2121 1009 0000 0002 3569 8741  
Bëhet: AL472121100900000000235698741

#### Hapi 1

Zhvendosim në të djathtë katër karakteret e para:  
Bëhet 2121100900000000235698741AL47

#### Hapi 2

Shkronjat konvertohen në numra sipas tabelës së pasqyruar në hapin 2, të aneksit 2:  
Bëhet 2121100900000000235698741102147

#### Hapi 3

Zbatohet algoritmi MOD 97-10 në përputhje me ISO 7064. Në mënyrë që shifra e kontrollit dhe karakteret korresponduese të konsiderohen korrekte, rezultati i marrë pas MOD 97-10 duhet të jetë 1.

Mbetja pas MOD 97 e 2121100900000000235698741102147 = 1

Shënim: Për saktësi llogaritjeje, rekomandohet përdorimi i numrave të plotë në vend të numrave dhjetorë. Nëse kodi është një numër relativisht i gjatë për të aplikuar modulën, atëherë përlogaritja mund të ndahet në përlogaritje të pjesës së mbetur referuar numrit të plotë, me një gjatësi maksimale 9 ose 18 karaktere. Referuar shembullit më lart, përlogaritja do të jetë:

- 9 shifrat e para të numrit pjesëtohen me 97  
 $212110090 / 97 = 2186701.96$
- pjesa e plotë e numrit të marrë nga pjesëtimi, shumëzohet përsëri me 97  
 $2186701 * 97 = 212109997$
- nga numri i parë 9-shifror zbresim numrin e dytë të marrë nga shumëzimi  
 $212110090 - 212109997 = 93$
- krijohet numri në vijim 9-shifror, i paraprirë nga diferenca e përfutur nga një hap më lart (93)  
 $930000002 / 97 = 9587628.887$
- pjesa e plotë e numrit të marrë nga pjesëtimi, shumëzohet përsëri me 97  
 $9587628 * 97 = 929999916$
- nga numri i parë 9-shifror zbresim numrin e dytë të marrë nga shumëzimi  
 $930000002 - 929999916 = 86$

Kjo procedurë përsëritet deri sa të përfshihen në përlogaritje të gjitha shifrat e numrit. MOD 97 i "201102147" = 1

#### **ANEKS 4**

### **METODA E PËRLLOGARITJES SË SHIFRËS SË KONTROLLIT (CHECK DIGIT) TË KIB**

Karakteri numerik në pozicionin 8 të KIB shërben si shifër kontrolli për 7 numrat e parë të kodit KIB. Shifra e kontrollit llogaritet sipas formulës së mëposhtme ku  $N_n$  është vlera numerike e karakterit të  $n$ -të të KIB:

$$N_8 = 10 - [(N_1 * 9 + N_2 * 7 + N_3 * 3 + N_4 * 1 + N_5 * 9 + N_6 * 7 + N_7 * 3) \text{ MOD } 10]$$

**ANEKS 5**  
**TABELË 1 – STRUKTURA E KIB**

Pozicioni	Qëllimi	Vlerat e mundshme
karakteri 1	Klasifikimi i OSHP	1. Banka Qendrore 2. Banka 3. Institucione të parasë elektronike 4. Institucione të pagesave 9. Degët e bankave të huaja
karakteret 2 dhe 3	Identifikimi i OSHP	Numër unik dy shifror për çdo OSHP
karakteret 4,5,6 dhe 7	Identifikimi i degës/agjencisë/agjentit të OSHP	Karakteret 4 dhe 5 – identifikues i rrethit, sipas tabelës 2; Karakteret 6 dhe 7 – numër unik dyshifror për çdo degë/agjenci/agjent të OSHP, që vendoset nga vetë OSHP.

Tabelë 2 – Ndarja administrative në rrethe e Republikës së Shqipërisë

Rajoni / Dega e BSH <sup>1</sup>	Numri i rajonit (2)	Rrethet (kryeqendrat) (3)	Numri i rrethit (4)	Identifikuesi i rrethit karakteret (2) dhe (4)
Tiranë	1	Tiranë	1	11
	1	Durrës	2	12
	1	Krujë	3	13
	1	Kurbini (Laç)	4	14
	1	Mirditë (Rrëshen)	5	15
	1	Kavajë	6	16
	1	Mat (Burrel)	7	17
Lushnje	2	Fier	1	21
	2	Lushnje	2	22
	2	Berat	3	23
	2	Kuçovë	4	24
	2	Skrapar (Çorovodë)	5	25
	2	Vlorë	6	26
	2	Mallakastër (Ballsh)	7	27
Elbasan	3	Elbasan	1	31
	3	Gramsh	2	32
	3	Peqin	3	33
	3	Librazhd	4	34
Korçë	4	Korçë	1	41
	4	Pogradec	2	42
	4	Devoll (Bilisht)	3	43
	4	Ersekë	4	44
Shkodër	5	Shkodër	1	51
	5	Malësi e Madhe (Koplik)	2	52
	5	Pukë	3	53
	5	Lezhë	4	54
	5	Kukës	5	55
	5	Has	6	56
	5	Tropojë (Bajram Curri)	7	57
	5	Dibër (Peshkopi)	8	58
	5	Bulqizë	9	59
Gjirokastrë	6	Gjirokastrë	1	61
	6	Përmet	2	62
	6	Sarandë	3	63
	6	Tepelenë	4	64
	6	Delvinë	5	65

<sup>1</sup> Numërimi i rretheve bëhet mbi baza rajonale, duke konsideruar si qendra të rajoneve qytetet ku ndodhen degët e Bankës së Shqipërisë.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
**Nr.28, datë 4.5.2022**

**PËR**  
**DISA NDRYSHIME NË FONDIN NUMIZMATIK TË BANKËS SË SHQIPËRISË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "g", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 11, shkronja "m" të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Kabinetit të Guvernatorit", të miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 28, datë 2.3.2016; me propozimin e Kabinetit të Guvernatorit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë një shtesë në fondin numizmatik për dhurata, pjesë e fondit numizmatik të Bankës së Shqipërisë, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 9, datë 6.2.2008 "Për miratimin e fondit numizmatik të Bankës së Shqipërisë", i ndryshuar, me vlerat e përcaktuara në aneksin 1 të këtij vendimi.
2. Shtesa në fondin numizmatik për dhurata sipas pikës 1 të këtij vendimi, të kryhet duke zbatuar procedurat përkatëse mbi funksionimin e Arkës Stok.
3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit, Departamenti i Emisionit dhe Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**KRYETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**GENT SEJKO**

## ANEKSI 1

Miraturar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 28, datë 4.5.2022

Shtesa e fondit numizmatik të dhuratave për specimenet e kartëmonedhave të reja, prerjet 500 Lekë dhe 2000 Lekë, emetime të vitit 2020.

Nr.	Vlerat numizmatike Kartëmonedha specimen	Fondi numizmatik për dhurata (në copë)
1	500 Lekë, specimen, viti 2020	50
2	2000 Lekë, specimen, viti 2020	50



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
GUVERNATORI**

**VENDIM**  
Nr.2202, datë 23.5.2022

**PËR  
DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SI  
AGJENT NË SIGURIME NGA INSTITUCIONI I PARASË ELEKTRONIKE "RPAY"  
SH.P.K.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 53, pika 4, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; dhe të nenit 64 pika 1, shkronja "e", nenit 65, pika 1, shkronja "d" e rregullores "Për licencimin e institucioneve të pagesave dhe institucioneve të parasë elektronike, si dhe për regjistrimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave", miratuar me vendimin nr. 59, datë 24.11.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë; pasi u njoha me kërkesën e institucionit të parasë elektronike "RPAY" sh.p.k., dhe bazuar në propozimin e Departamentit të Mbykëqyrjes,

VENDOSA:

1. Miratimin paraprak për institucionin e parasë elektronike "RPAY" sh.p.k. për ushtrimin e veprimtarisë si agjent në sigurime.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**GUVERNATOR**

**GENT SEJKO**





## **TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 24, NUMËR 1, SHKURT 2022**

1. Licencë nr. 52, datë 21.1.2022 "Për të vepruar si institucion i parasë elektronike"
2. Licencë nr. 53, datë 28.1.2022 "Për të vepruar si institucion i parasë elektronike"
3. Licencë nr. 54, datë 1.2.2022 "Për të vepruar si institucion financiar i mikrokredisë në Republikën e Shqipërisë"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 5, datë 2.2.2022 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 6, datë 2.2.2022 "Për pezullimin e shpërndarjes së fitimit nga bankat"
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 7, datë 2.2.2022 "Për miratimin e rregullores "Për regjistrin publik të ofruesve të shërbimeve të pagesave""
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 9, datë 2.2.2022 "Për rishtypjen e monedhave metalike shqiptare me kurs ligjor, me prerje 10 Lekë"
8. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 10, datë 2.2.2022 "Për rishtypjen e kartëmonedhave shqiptare me kurs ligjor, me prerje 5000 Lekë"

## **TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 24, NUMËR 2, PRILL 2022**

1. Udhëzim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 1, datë 2.3.2022 "Për kriteret për përcaktimin e shumës monetare minimale të siguracionit të dëmshpërblimit profesional ose të garancive të tjera të krahasueshme"
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 13, datë 23.3.2022 "Për rritjen e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 14, datë 23.3.2022 "Për miratimin e "Pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë për vitin 2021"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 17, datë 23.3.2022 "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 9, datë 6.2.2008 "Për miratimin e fondit numizmatik të Bankës së Shqipërisë""
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 18, datë 23.3.2022 "Për emërimin e kryetarit dhe anëtarit të Komitetit të Auditit të Bankës së Shqipërisë"
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 20, datë 6.4.2022 "Për miratimin e disa ndryshimeve në dokumentin "Politika e auditimit të brendshëm në Bankën e Shqipërisë"
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 21, datë 6.4.2022 "Për disa ndryshime në rregulloren "Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre"
8. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 22, datë 6.4.2022 "Për zgjedhjen e "London School of Economics and Political Science", si bashkëpunëtor i jashtëm i Bankës së Shqipërisë dhe delegimin e kompetencës për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit"
9. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 23, datë 6.4.2022 "Për emërimin e Zëvendësguvernatorit të Dytë të Bankës së Shqipërisë"



